ASCAP

VEPRIMTARI PRAKTIKE

NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT

Klasa VI

Art pamor | Muzikë | Edukim fizik, sporte dhe shëndet

www.ascap.edu.al

2026

PËRMBAJTJA

I. HYRJE 3

II. QËLLIMI I UDHËZUESIT 3

III. PËRDORUESIT E UDHËZUESIT 4

IV. PARIMET E HARTIMIT TË VEPRIMTARIVE PRAKTIKE 5

V. LIDHJA E VEPRIMTARIVE PRAKTIKE ME REZULTATET E TË NXËNIT 6

VI. VEPRIMTARITË PRAKTIKE 8

1. LËNDA: ART PAMOR 8

2. LËNDA: MUZIKË 22

3. LËNDA: EDUKIM FIZIK 30

I. HYRJE

Përditësimi i Kornizës Kurrikulare, i kurrikulave bërthamë dhe i programeve lëndore në arsimin parauniversitar ka sjellë nevojën për rishikimin e mënyrës së planifikimit, organizimit dhe zhvillimit të procesit mësimor, duke e orientuar atë më qartë drejt të nxënit aktiv dhe përfshirjes së nxënësit në situata autentike të të nxënit. Këto përditësime synojnë forcimin e koherencës ndërmjet qëllimeve kurrikulare, rezultateve të të nxënit dhe praktikës mësimore në klasë. Veprimtaritë praktike gjatë orës mësimore përbëjnë një komponent thelbësor për përvetësimin e njohurive, koncepteve dhe aftësive, si dhe për arritjen e rezultateve të të nxënit. Ato u krijojnë nxënësve mundësi konkrete për të zbatuar njohuritë në situata nga jeta e përditshme dhe kontekste reale, për të zhvilluar aftësi praktike, për të ndërtuar njohuri të qëndrueshme dhe për të demonstruar kompetencat e synuara. Në këtë mënyrë, procesi mësimor zhvendoset nga një qasje e fokusuar kryesisht në transmetimin e njohurive drejt një të nxëni aktiv, të mbështetur në veprim, eksplorim, bashkëpunim dhe reflektim. Përditësimet kurrikulare theksojnë gjithashtu përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies, të cilat marrin në konsideratë diversitetin e nxënësve, ritmet e ndryshme të të nxënit dhe ndërlidhjen ndërmjet lëndëve. Në këtë kontekst, veprimtaritë praktike shërbejnë si element lidhës ndërmjet përmbajtjes së programeve lëndore dhe përvojave konkrete të nxënësve, duke ndikuar pozitivisht në motivimin dhe angazhimin e tyre në procesin e të nxënit. Ky udhëzues synon të mbështesë mësuesit në zbatimin e programeve lëndore të përditësuara, duke ofruar shembuj orientues të veprimtarive praktike sipas cikleve arsimore, klasave dhe lëndëve përkatëse. Veprimtaritë e përfshira janë hartuar në përputhje me parimet e programit lëndor dhe synojnë të lehtësojnë planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e orëve mësimore që kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e kompetencave dhe përmbushjen e rezultateve të të nxënit.

II. QËLLIMI I UDHËZUESIT

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të shërbejë si një instrument mbështetës për mësuesit në zbatimin sa më cilësor të programeve të përditësuara lëndore, përmes veprimtarive praktike mësimore të orientuara drejt përmbushjes së rezultateve të të nxënit dhe zhvillimit të kompetencave kyçe, si dhe kompetencave specifike të lëndës. Ai synon të lehtësojë kalimin nga dokumenti kurrikular në zbatimin konkret të tij në klasë, duke ofruar shembuj veprimtarish të strukturuara, të shpjeguara qartë dhe të përshtatshme për kontekste të ndryshme mësimore.

Nëpërmjet veprimtarive të propozuara, udhëzuesi mbështet mësuesit në planifikimin dhe organizimin e situatave të të nxënit që nxisin pjesëmarrjen aktive të nxënësve, zhvillojnë mendimin kritik, aftësinë për zgjidhjen e problemeve, bashkëpunimin dhe komunikimin. Këto veprimtari synojnë të krijojnë lidhje funksionale ndërmjet njohurive teorike dhe përvojave konkrete në klasë, duke ndihmuar nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet e reja, t'i zbatojnë ato në situata praktike dhe të ndërtojnë njohuri të qëndrueshme.

Udhëzuesi ofron orientime për përzgjedhjen dhe përdorimin e metodave dhe strategjive bashkëkohore të mësimdhënies, duke nxitur përshtatjen e tyre sipas karakteristikave të klasës, ritmeve dhe stileve të ndryshme të të nxënit, si dhe nevojave individuale të nxënësve. Në këtë mënyrë, ai kontribuon në zhvillimin e një mësimdhënieje gjithëpërfshirëse, fleksibile dhe të orientuar drejt nxënësit.

Gjithashtu, udhëzuesi synon të mbështesë koherencën ndërmjet planifikimit mësimor, zbatimit të orës së mësimit dhe vlerësimit të të nxënit, duke ndihmuar mësuesit të lidhin më qartë rezultatet e të nxënit me veprimtaritë konkrete. Kjo qasje ndihmon në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor dhe në monitorimin më të mirë të progresit të nxënësve.

Udhëzuesi synon të kontribuojë në unifikimin e praktikave mësimore, në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe në forcimin e rolit të mësuesit si lehtësues i të nxënit dhe udhëheqës pedagogjik në klasë, duke mbështetur zbatimin koherent dhe të qëndrueshëm të kurrikulës dhe programeve të përditësuara.

III. PËRDORUESIT E UDHËZUESIT

Ky udhëzues është hartuar për të mbështetur aktorë të ndryshëm të përfshirë në procesin arsimor, duke synuar zbatimin sa më efektiv të kurrikulës së përditësuar në praktikën e përditshme mësimore. Përdoruesit kryesorë të tij janë mësuesit e arsimit parauniversitar, sipas cikleve arsimore, klasave dhe lëndëve për të cilat janë hartuar veprimtaritë praktike. Për mësuesit, udhëzuesi shërben si material referues për planifikimin ditor, javor dhe afatmesëm të mësimit, duke ofruar shembuj veprimtarish që mund të përzgjidhen, përshtaten ose kombinohen në funksion të rezultateve të të nxënit, nivelit të klasës dhe karakteristikave të nxënësve.

Veprimtaritë e paraqitura nuk kanë karakter detyrues, ato janë orientuese dhe fleksibile, duke i lënë mësuesit hapësirë për përshtatje sipas kontekstit të klasës, ritmeve dhe stileve të ndryshme të të nxënit, si dhe nevojave individuale të nxënësve. Në këtë mënyrë, udhëzuesi lidhet

drejtpërdrejt me procesin e planifikimit mësimor dhe me vlerësimin e të nxënit, duke ndihmuar mësuesit të ndërtojnë situata të të nxënit që mbështesin zhvillimin e kompetencave dhe monitorimin e progresit të nxënësve.

Udhëzuesi është gjithashtu një mbështetje për kryetarët e ekipeve lëndore dhe drejtuesit e rrjeteve profesionale, të cilët mund ta përdorin për të nxitur shkëmbimin e praktikave të mira, për të organizuar diskutime profesionale dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet mësuesve. Ai shërben si referencë e përbashkët për reflektim profesional dhe për harmonizimin e praktikave mësimore në nivel shkolle apo rrjeti.

Udhëzuesi përbën një burim të dobishëm edhe për trajnerët duke ofruar shembuj konkretë të praktikave mësimore dhe orientime për zhvillimin profesional të mësuesve. Në një këndvështrim informues, udhëzuesi mund të shërbejë edhe për prindërit, duke i ndihmuar të kuptojnë më qartë mënyrën se si organizohen veprimtaritë praktike dhe si lidhen ato me zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të nxënësve.

IV. PARIMET PËR HARTIMIN E VEPRIMTARIVE PRAKTIKE

Hartimi dhe zbatimi i veprimtarive praktike në këtë udhëzues mbështetet në parimet themelore të kornizës kurrikulare dhe të programeve të arsimit parauniversitar. Është e rëndësishme të theksohet se ***udhëzuesi nuk trajton zhvillimin e plotë të një ore mësimore***, ***por ofron modele të veprimtarive të veçanta mësimore,*** të cilat mund të integrohen në struktura të ndryshme të orës, në varësi të planifikimit të mësuesit dhe qëllimeve të përcaktuara në programin lëndor.

Veprimtaritë janë ndërtuar në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënit dhe sigurimit të koherencës ndërmjet programit lëndor, zbatimit në klasë dhe vlerësimit. Ato synojnë të konkretizojnë në praktikë përditësimet kurrikulare, duke mbështetur zhvillimin e nxënësit si individ aktiv, i përgjegjshëm dhe i aftë për të zbatuar njohuritë në situata të ndryshme.

Veprimtaritë praktike udhëhiqen nga këto parime:

- Qasja e bazuar në kompetenca. Çdo veprimtari synon integrimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve në situata konkrete të të nxënit, duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave kyçe dhe atyre specifike të lëndës.
- Nxënësi në qendër të procesit. Veprimtaritë marrin në konsideratë karakteristikat zhvillimore, interesat, ritmet dhe stilet e ndryshme të të nxënit, duke garantuar përfshirje aktive dhe angazhim kuptimplotë.

- Të nxënit aktiv dhe përmes përvojës. Të nxënit realizohet përmes veprimit, eksplorimit, analizës, diskutimit dhe reflektimit, duke nxitur ndërtimin e njohurive të qëndrueshme.
- Lidhja me kontekste reale. Veprimtaritë krijojnë mundësi për zbatimin e njohurive në situata autentike, duke rritur kuptimin dhe relevancën e të nxënit.
- Bashkëpunimi dhe komunikimi. Puna në grup, shkëmbimi i ideve dhe ndërveprimi i strukturuar kontribuojnë në zhvillimin e aftësive sociale dhe qytetare.
- Gjithëpërfshirja. Veprimtaritë janë konceptuar në mënyrë që të krijojnë mundësi reale pjesëmarrjeje për të gjithë nxënësit, duke respektuar diversitetin dhe nevojat individuale.
- Fleksibiliteti në zbatim. Veprimtaritë janë orientuese dhe mund të përshtaten sipas kontekstit të klasës, burimeve në dispozicion dhe nivelit të nxënësve, pa cenuar rezultatet e synuara.
- Vlerësimi për të nxënit. Vlerësimi integrohet natyrshëm brenda veprimtarisë, përmes vëzhgimit, pyetjeve orientuese, reflektimit dhe vetëvlerësimit, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të të nxënit.

V. LIDHJA E VEPRIMTARIVE PRAKTIKE ME REZULTATET E TË NXËNIT

Veprimtaritë praktike të përfshira në këtë udhëzues janë hartuar në lidhje të drejtpërdrejtë me rezultatet e të nxënit të përcaktuara në programet lëndore, sipas tematikave përmbajtësore përkatëse. Kjo do të thotë se veprimtaria nuk paraqitet si aktivitet i izoluar, por si pjesë funksionale e arritjes së objektivave të përcaktuara në program.

Lidhja ndërmjet rezultateve të të nxënit dhe veprimtarive praktike bazohet në parimin e koherencës kurrikulare. Për secilën tematikë janë identifikuar rezultatet përkatëse dhe janë propozuar veprimtari që u krijojnë nxënësve mundësi reale për t'i demonstruar ato përmes veprimit, analizës, diskutimit, argumentimit apo zgjidhjes së situatave problemore. Në këtë mënyrë, fokusi nuk qëndron vetëm në përvetësimin e njohurive faktike, por në aftësinë për t'i përdorur ato në kontekste të ndryshme dhe për të ndërtuar kuptim të thelluar.

Përmes veprimtarive praktike, nxënësit kanë mundësi të tregojnë se kuptojnë konceptet, të aplikojnë njohuritë në situata të reja, të analizojnë informacionin, të bashkëpunojnë me të tjerët dhe të reflektojnë mbi procesin e të nxënit. Kjo e bën të dukshme arritjen e rezultateve jo vetëm në nivel njohurish, por edhe në nivel aftësish dhe qëndrimesh. Veprimtaritë krijojnë gjithashtu hapësirë për diferencim, duke i mundësuar mësuesit të përshtatë kërkesat sipas nivelit të nxënësve, pa devijuar nga rezultatet e synuara.

Kjo lidhje e qartë ndërmjet rezultateve të të nxënit dhe veprimtarive praktike mbështet mësuesin në planifikimin e qëndrueshëm të procesit mësimor dhe në përzgjedhjen e metodave të përshtatshme. Ajo lehtëson gjithashtu vlerësimin e progresit të nxënësve, pasi kriteret e vlerësimit mund të ndërtohen drejtpërdrejt mbi rezultatet që synohen të arrihen përmes veprimtarisë.

Udhëzuesi ofron një kornizë praktike që garanton koherencë ndërmjet planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit, duke e bërë procesin mësimor më të strukturuar, më transparent dhe më të orientuar drejt arritjeve konkrete të nxënësve.

VI. VEPRIMTARI PRAKTIKE

1. LËNDA: ART PAMOR

TEMATIKA 1: GJUHA DHE KOMUNIKIMI ARTISTIK

Rezultat i të nxënit	*Veprimtari praktik*
Zhvillon kompozime kreative duke përdorur ritme të përsëritura me pika dhe shenja.	**Hapi I.** Mësuesi prezanton në klasë materiale të ndryshme me te cilat demonstron lloje shenjash. Shihni këto shenja edhe pse të gjitha nisin si një pikë, ato kanë karakter dhe forcë të ndryshme. Cilën prej tyre do të zgjidhnit ju për të realizuar një krijim artistik?

	Hapi II. Pas diskutimit, klasa ndahet në 4 grupe. Qëllimi është që secili grup të krijojë "gjurmët "e tij sipas teknikës që përfaqëson. Grupet punojnë paralelisht për të krijuar detajet e punës së përbashkët: *Grupi "Shenja Grafike"*: Krijon tekstura me pika (laps, rapidograf) duke u fokusuar te dendësia e shenjës. *Grupi "Shenja Piktorike"*: Krijon "pika ngjyre "duke eksploruar se si ngjyra krijon shenjë. *Grupi "Shenja Plastike":* Modelon me plastelinë ose letër, duke i dhënë shenjës peshë dhe volum. *Grupi "Shenja Arkitektonike*": Organizon elementet, duke e shndërruar shenjën në një strukturë që krijon vëllim dhe lartësi. **Hapi III.** Punimet e te gjitha grupeve ekspozohen si një punim i vetëm në një ambient të klasës. Nxënësit ftohen të analizojnë veprën e përbashkët. Ata nuk po shohin më thjesht punën e tyre, por se si shenja ka ndryshuar stil dhe teknikë. Si ndryshon karakteri i shenjës kur ajo transformohet nga një njollë boje, në një element plastik me vëllim apo në një strukturë arkitektonike?

Zbaton teknika të thjeshta për të krijuar iluzionin e hapësirës në një sipërfaqe dy dimensionale.	**Hapi I.** Veprimtaria mësimore fillon me shfaqjen e një video të shkurtër të botës nënujore. Imagjinoni sikur po vëzhgoni botën nënujore përmes xhamit të një nëndetëseje: Si do ta krijonit iluzionin e hapësirës në vizatimin tuaj, që oqeani të duket sikur vazhdon thellë brenda letrës dhe jo si një figurë e rrafshët? **Hapi II.** Mësuesi udhëheq nxënësit gjate punës për ndërtimin e kompozimit duke u bazuar në tri plane thellësie. Procesi nis me organizimin e planit të parë, ku format paraqiten me përmasa të mëdha dhe detaje të qarta, për të vijuar me zvogëlimin e tyre gradual drejt planeve të mesme dhe të fundit. Mësuesi pyet: Shiko elementet që ke vizatuar, si mund t'i pozicionosh ato që të na krijosh ndjesinë se oqeani yt ka disa plane dhe jo sikur të gjithë peshqit po notojnë në të njëjtën vijë? Si ndryshon nuanca e ngjyrës kur duam të tregojmë distancën midis një objekti që e kemi shumë pranë dhe një tjetri që humbet në thellësi të oqeanit?

	 Hapi III. Veprimtaria përmbyllet me ekspozimin e punimeve ne klase, ku nxënësit ftohen të vëzhgojnë krijimet e tyre dhe të shokëve. Mësuesi nxit nxënësit të identifikojnë punimet ku iluzioni i thellësisë është më i besueshëm, duke drejtuar pyetjen: Cilat punime ju krijojnë iluzionin e një hapësire që vazhdon në pafundësi dhe çfarë teknikash dalloni aty?
Identifikon simetrinë, asimetrinë dhe simetrinë rrethore në natyrë dhe në art.	**Hapi I.** Veprimtaria mësimore fillon me shfaqjen e imazheve nga natyra dhe vepra arti. Mësuesi I drejton pyetje nxënësve: Në cilat nga këto imazhe, po të fshihnim gjysmën me dorë, ju do të ishit të aftë ta vizatonit pjesën tjetër pa e parë fare? Në cilat imazhe do ta kishit të pamundur sepse ana tjetër na ndryshon me forma të reja? Nëse do të vendosnit majën e gishtit mbi imazh, te cilat figura mendoni se çdo gjë nis nga një pikë e vetme në qendër dhe shpërndahet drejt anëve? Nxënësit ngrihen radhazi në tabelë për të argumentuar përgjigjet e tyre rreth imazheve dhe diskutojnë. **Hapi II.** Në këtë fazë, nxënësit bashkëpunojnë me shokun e bankës për të realizuar detyrën, duke përdorur objektet natyrore si "mjete" krijuese. Fleta e vizatimit shërben si një hapësirë për të krijuar tri zona të ndryshme: një ku vërtetohet simetria përmes teknikës së stampimit me palosje, një ku krijohet asimetri duke balancuar "peshat" vizuale të objekteve

	që nuk ngjasojnë, dhe një ku ndërtohet simetria rrethore duke u nisur nga një pikë qendrore. Mësuesi lëviz mes bankave për të nxitur nxënësit.  **Hapi III.** Mësuesi udhëheq fazën e reflektimit për të verifikuar nëse nxënësit arritën të identifikonin saktë llojet e baraspeshës. Klasa vëzhgon punimet e realizuara dhe mësuesi nxit nxënësit të reflektojnë mbi punën e tyre me pyetjen: Gjatë krijimit, cili lloj i baraspeshës ju sfidoi më shumë dhe pse?

Eksperimenton me kombinime ngjyrash për të krijuar kompozime të ndryshme.	**Hapi I.** Mësuesi paraqet përpara klasës vetëm tri ngjyrat bazë(primare): të kuqe, të verdhë dhe blu. **Ngjyrat primare** Ngjyrat dytesore krijohen duke përzier dy ngjyra primare. **Skema ilustruese** E kuqe + E verdhë = Portokalli E verdhë + Blu = Jeshile Blu + E kuqe = Vjollcë Mësuesi pyet: "Nëse bota do të kishte vetëm këto tri ngjyra, si do t'i krijonit të tjerat? Nxënësit japin idetë e tyre të cilat shkruhen në tabelë dhe mësuesi demonstron për të vërtetuar përgjigjet. **Hapi II.** Mësuesi shpërndan në mënyrë të rastësishme shirita me kombinime të ndryshme ngjyrash (nuanca të ngrohta, të ftohta, apo të përziera) të përgatitura e parë. Çdo nxënës zgjedh një shirit dhe ka si detyrë të përpiqet të rikrijojë vetë këto ngjyra përmes përzierjes së bojërave. Gjatë këtij procesi, nxënësit eksperimentojnë duke ndryshuar raportet e ngjyrave, duke shtuar më shumë ose më pak nga secila për të arritur sa më afër nuancës së dhënë, por edhe duke krijuar variante të reja. Pasi krijojnë paletën e tyre të ngjyrave, ata i përdorin këto për të realizuar një kompozim të lirë, duke u bazuar te ngjyrat e shiritit por dhe duke shprehur kreativitetin personal. **Hapi III.** Në fund të orës nxënësit dalin me radhë dhe tregojnë kompozimet e tyre. Shokët e klasës përpiqen të gjejnë se cilat ngjyra bazë janë përzier për të krijuar atë rezultat ngjyrash. Pas prezantimeve bëhet një diskutim i shkurtër reflektues me pyetjen: Cilat ngjyra ju pëlqejnë më shumë dhe çfarë mendoni se ndikon në zgjedhjen tuaj për to?

TEMATIKA 2: TEKNIKA DHE PROCESET ARTISTIKE

Rezultat i të nxënit	Veprimtari praktike
Krijon duke përdorur karakteristikat shprehëse të mjeteve të vizatimit si: gradacionet tonale të lapsit dhe gomës, karbonit etj..	**Hapi I.** Veprimtaria mësimore fillon me eksplorimin e mjeteve përmes krijimit të një shkalle gradacioni tonal në anën e fletës së punës. Gjatë kësaj faze, nxënësit ushtrojnë dorën duke kaluar gradualisht nga tonet më të hapura te ato më të errëta, duke rritur shtypjen e lapsit mbi letër dhe duke përdorur gomën jo vetëm për fshirje, por si një mjet për të nxjerr në pah dritën mbi zonat e errësuara.  **Hapi II.** Pas ndërtimit të gradacionit tonal, nxënësit nisin punën individuale për zbatimin e gradacioneve tonale mbi një natyrë të qetë të përbërë nga një kub dhe dy fruta(p.sh. një mollë dhe një një dardhë),duke zbuluar ndryshimin midis formave gjeometrike dhe atyre organike. Fokusi është te përdorimi i mjeteve: nxënësit vëzhgojnë se si drita krijon hije të forta te qoshet e kubit dhe hije të buta e të rrumbullakëta te frutat. A mund t'i ktheni këto figura në objekte që duken si të vërteta duke përdorur vetëm lapsin dhe gomën?

	   **Hapi III.** Prezantimi i punimeve dhe një diskutim reflektues mbi përdorimin e mjeteve. Nxënësve ju drejtohen pyetje: Si arritët të krijonit shkallëzim tonal në natyrën e qetë, duke përdorur vetëm lapsin dhe gomën, për t'u dhënë objekteve vëllim dhe pamje reale?
Përdor elementët bazë të artit pamor (linjë, formë, ngjyrë,	**Hapi I**. Mësuesi e nis veprimtarinë duke i vendosur nxënësit në rolin e një "agjencie reklamimi". Diskutohet: Çfarë bën një agjenci dhe si ndihmon ajo në shitjen e një produkti? Çfarë e bën një produkt tërheqës për konsumatorin përveç cilësisë së tij? Mësuesi prezanton detyrën: krijimi i një produkti ushqimor ose kozmetik që duhet të

kompozim) në funksion të dizajnit.	reklamohet dhe të dalë në treg, duke përcaktuar qartë kriteret e suksesit si lexueshmëria e emrit, përshtatshmëria e ngjyrave dhe qartësia e logos. **Hapi II.** Nxënësit nisin të punojnë në grupe me 4 nxënës ku secili merr një rol specifik si dizajner, krijues logoje apo përgjegjës reklamimi. Ata zgjedhin produktin (p.sh. patatina, çokollatë, pije, shampo, krem) dhe realizojnë një skicë fillestare në letër ku përcaktojnë emrin, logon dhe kompozimin e paketimit. Gjatë kësaj faze, nxënësit eksperimentojnë me linjën, formën, ngjyrën dhe teksturën për të krijuar një dizajn tërheqës. Mësuesi ndërhyn me një demonstrim të shkurtër në Canva, duke treguar se si elementet e artit pamor shndërrohen në një dizajn grafik digjital profesional.

	 Hapi III. Në përfundim mësuesi e kthen klasën në një lojë të shkurtër 'klienti voton'gjate prezantimit te punimeve.Secili nxënës voton me ngritje dore për produktin që i duket më tërheqës vizualisht,ndërsa disa prej tyre argumentojnë shkurtimisht përzgjedhjen e tyre.
Zbaton gdhendjen në materiale të buta (p.sh. sapun, bukpeshk),duke përdorur mjete të përshtatshme.	**Hapi I.** Mësuesi ka vendosur në tavolinë fruta dhe perime të ndryshme (mollë, patate, karota, dardhë). Nxit diskutimin: Vëzhgoni me kujdes format e frutave që keni mbi tavolinë. Si mund ta kthejmë këtë patate në një personazh, duke hequr material prej saj dhe jo duke i shtuar? Mësuesi demonstron shpejt se si një gërryerje e vogël me lugë krijon një gropë (thellësi)dhe si një vizë me kunj druri krijon një detaj mbi lëkurën e frutit. **Hapi II.** Në këtë fazë, nxënësi nis punën individuale duke vizatuar fillimisht në një fletë të vogël skicën e personazhit apo figurës që ka përzgjedhur. Fleta vendoset mbi sipërfaqen e frutit ose perimes dhe, duke përdorur një kunj druri ose majën e lapsit, nxënësi shpon lehtë letrën përgjatë vijave të skicës për të lënë gjurmën e figurës mbi lëkurën e frutit. Pasi hiqet letra, nxënësi fillon gdhendjen me ndihmën e një luge të vogël, një thike plastike apo kunjave të drurit për të gërryer materialin dhe për të nxjerrë në pah figurën.

	 Gjatë këtij procesi, mësuesi vëzhgon me kujdes punën e nxënësve, duke i udhëzuar ata për përdorimin e sigurt të mjeteve dhe duke i ndihmuar në realizimin sa më të saktë të detajeve të figurës. **Hapi III.** Punimet e përfunduar ekspozohen në klasë. Nxënësit bashkëbisedojnë rreth punës së tyre dhe të shokëve. Mësuesi drejton pyetje: Çfarë ndryshimi pësoi forma fillestare e frutit gjatë procesit të gdhendjes dhe si ju ndihmuan mjetet për të krijuar detaje? A do të ishin të përshtatshme këto mjete për gdhendjen e materialeve më të ngurta, si druri apo guri?
Identifikon elementët bazë arkitektonikë, *Si muret, dritaret, kolonat, harku etj. në objekte të thjeshta ndërtimi.*	**Hapi I.** Mësimi fillon me shfaqjen në projektor të disa imazheve të objekteve të thjeshta të ndërtimit që u përkasin periudhave të ndryshme kohore (si p.sh. një shtëpi antike me kolona, një urë e thjeshtë guri me hark apo një banesë moderne me forma gjeometrike).

	Pasi vëzhgojnë ndërtesat, mësuesi nxit nxënësit të identifikojnë elementët e përbashkët përmes pyetjes: Duke vëzhguar këto struktura të periudhave të ndryshme, cilat janë disa nga elementet e përbashkëta që arkitektët kanë përdorur përgjatë shekujve? Ku i dalloni konkretisht këto elemente, si kolonat, harqet, muret apo dritaret në imazhet që po shfaqen në projektor? **Hapi II.** Nxënësit nisin procesin e ndërtimit të strukturës duke përdorur materiale të thjeshta (shkopinj druri, kruajtëse dhëmbësh, shirita kartoni ose pipëza) dhe plastelinë si mjet bashkues në nyje. Mësuesi orienton nxënësit për krijimin e nyejve lidhëse me plastelinë, duke i lënë ata të lirë të eksperimentojnë me lartësinë dhe stabilitetin e strukturës. Nxënësit ndërtojnë skeletin e ndërtesës me shkopinj vertikalë dhe horizontalë, si dhe formojnë hapësirat për dritaret apo harqet, duke u fokusuar tek realizimi teknik i strukturës.  **Hapi III.** Mësuesi udhëzon nxënësit të diskutojnë rreth procesit të ndërtimit dhe rezultateve të arritura. Punimet ekspozohen në klasë dhe nxënësit nxiten të argumentojnë zgjedhjet e tyre: Si ndikon vendosja e kolonave dhe harqeve në qëndrueshmërinë e strukturës suaj? Nisur nga modeli që keni në dorë, cilat pjesë përfaqësojnë gurin, xhamin apo tullën në një ndërtesë reale?

TEMATIKA 3: HISTORIA, ARTI DHE SHOQËRIA

Rezultat i të nxënit	Veprimtarive praktike
Identifikon elementët e gjuhës vizuale, teknikën e përdorur, aspektet historike në një vepër arti.	**Hapi I.** Mësuesi shfaq në projektor vepra arti në përshtatje me temën mësimore nga tematika "Historia, arti dhe shoqëria". Nxënësit ndahen në grupe me 3-4 nxënës dhe çdo grup përzgjedh një nga veprat e artit. Punës i bashkëngjiten fisha orientuese me pyetje specifike rreth veprës: Cilët janë elementët kryesorë të gjuhës vizuale (vija, ngjyra, forma) që dalloni? Çfarë informacioni na jep kjo vepër për periudhën historike kur është krijuar? Cila teknikë mendoni se është përdorur nga autori? Mësimi vijon me një bashkëbisedim rreth pyetjeve në fishat e shpërndara nga mësuesi. **Hapi II.** Pas bashkëbisedimit, grupet kalojnë në aktivitetin praktik: riprodhimi i veprës së përzgjedhur ose i një sekuence të shkëputur prej saj. Nxënësit punojnë në grup për të riprodhuar teknikën dhe stilin historik, duke u fokusuar te përshtatja e ngjyrave dhe saktësia e linjave që identifikuan në hapin e parë. Mësuesi udhëzon grupet të ruajnë karakterin origjinal të veprës, por duke i dhënë një prekje personale përmes bashkëpunimit. Figura A: VE PRA ORIGJINALE Figura B: RIPRODHIMI I NXËNËSIT

	Hapi III. Mësuesi drejton nxënësit të ekspozojnë punimet e tyre në një mini-galeri brenda klasës. Secili grup prezanton riprodhimin e realizuar dhe argumenton zgjedhjet teknike. Nxënësit dëgjues drejtojnë pyetje për grupin prezantues rreth identifikimit të elementeve vizuale. Në mbyllje, mësuesi nxit reflektimin përmbyllës përmes pyetjes: Çfarë zbuluat rreth periudhës artistike përmes riprodhimit të kësaj vepre, që nuk do ta kishit vënë re thjesht duke e vëzhguar atë?
Prezanton informacionin e mbledhur rreth objekteve të artizanatit dhe trashëgimisë kulturore nëpërmjet përdorimit të teknologjisë.	**Hapi I.** Mësuesi liston në dërrasë qytetet antike (Butrinti, Apolonia, Durrësi, Bylisi) dhe udhëzon nxënësit të punojnë si "kërkues të historisë". Klasa ndahet në grupe (me nga 5-6 nxënës) dhe secili grup përdor tabletët për të identifikuar dëshmi kyçe të qytetit të përzgjedhur, si: një element arkitektonik, një objekt artizanati ose një mozaik/afresk. **Hapi II.** Nxënësit kalojnë në fazën e përpunimit krijues duke ndërtuar një "Kartolinë digjitale" në Canva. Ata i pasqyrojnë fotot e mbledhura në një faqe të vetme (Slide),duke u vendosur etiketa informuese që specifikojnë emrin e objektit, materialin dhe vendndodhjen. Për të lidhur antikitetin me gjuhën vizuale bashkëkohore, nxënësit përdorin elemente grafike moderne (si emoji apo ilustrime digjitale). 

	Hapi III. Punimet e realizuara shfaqen në projektor, duke krijuar një ekspozitë virtuale të menjëhershme. Ky moment shërben për një diskutim reflektues përmes pyetjeve: Si na ndihmon kërkimi digjital për të kuptuar madhështinë dhe rëndësinë e këtyre ndërtesave antike? Pse mendoni se është e rëndësishme që sot të përdorim teknologjinë për të dokumentuar dhe mbrojtur trashëgiminë tonë kulturore?

2. LËNDA: MUZIKË

TEMATIKA 1: GJUHA DHE KOMUNIKIMI MUZIKOR

Rezultat i të nxënit	*Veprimtari praktike*
Shkruan notat muzikore në vijë dhe fusha, sipër dhe poshtë pentagramit.	**Hapi I. Prezantimi i situatës** Veprimtaria mësimore fillon me shfaqjen e një pentagrami në projektor ose tabelë interaktive. Mësuesi prezanton melodinë fillestare dhe pyet nxënësit: "Cilat nota dëgjoni?" Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe identifikojnë ndryshimet në lartësitë e tingujve. **Hapi II. Punë në grupe** Nxënësit marrin fletore ose tabletë me pentagram dhe shënojnë notat që dëgjojnë. Mësuesi kalon nga tavolina në tavolinë për të ndihmuar nxënësit që kanë vështirësi. Më pas vazhdohet me një lojë bashkëpunuese ku nxënësit ndahen në grupe të vogla. Çdo grup krijon melodi të vogël me kartolina notash që i vendosin në pentagramin e madh të klasës. Të tjerët japin komente konstruktive, duke diskutuar pse nota është vendosur saktë ose gabim. Përdorimi i teknologjisë është një nga aftësitë që zhvillon kompetencën digjitale edhe kompetencën STEM dhe nxit nxënësit të shkruajnë melodinë në aplikacione si *Simplypiano*, *Noteflight* ose *Flat.io* duke i luajtur në klasë. Mësuesi i udhëzon për *vetëvlerësim:* "Dëgjo melodinë dhe kontrollo lartësinë e çdo note." **Hapi III. Reflektimi**

	Mësuesi nxit nxënësit të shkruajnë një paragraf të shkurtër cilat nota i vunë më lehtë dhe cilat më vështirë në/poshtë dhe sipër pentagramit, duke mësuar të analizojnë procesin e shkrimit të notave muzikore.
Zbaton njohuritë mbi lidhjen vlerëse dhe shprehëse në shembuj të thjeshtë muzikore.	**Hapi I: Prezantimi i veprimtarisë** Veprimtaria mësimore fillon me vendosjen e një kënge të thjeshtë duke e interpretuar dhe ndryshuar vlerat e disa notave për të treguar ndryshimin e shprehjes. **Hapi II. Punë në grupe** Më pas zhvillohet analizë në grup, ku nxënësit ndahen në grupe me 3-4 vetë. Secili grup ka një kopje të këngës dhe shënon *vlerat e notave dhe lidhjet shprehëse të tyre.* Më pas zhvillohet një veprimtari, ku grupi ndryshon një notë ose dy dhe provon efektin e shprehjes muzikore. Ata e luajnë variantin e ndryshuar dhe diskutojnë se çfarë ndryshoi në emocionin e këngës. Më pas bëhet një *diskutim* ku çdo grup prezanton variantin e tyre dhe shpjegon *zgjedhjet ritmike dhe melodike,* duke përdorur terminologji muzikore. Gjithashtu, nxënësit e tjerë japin koment dhe sugjerime. **Hapi III. Reflektimi** Mësuesi drejton një reflektim individual, ku nxënësit mund të shkruajnë një paragraf të shkurtër: *"Cila ndryshon më shumë shprehjen: vlera apo lidhja e notave?".*
Lexon në kohët 2/4, 3/4, 4/4.	**Hapi I: Prezantimi i veprimtarisë** Veprimtaria mësimore fillon luajtjen e një ritmi të thjeshtë nga mësuesi me duartrokitje ose instrumente Orf dhe pyet nxënësit: "Cila është koha e këtij ritmi?" Nxënësit përgjigjen dhe mësuesi diskuton me ta përgjigjet. **Hapi II. Veprimtari mësimore e drejtuar**

	Më pas zhvillohet një veprimtari mësimore (a) e drejtuar, ku nxënësit lexojnë ritmet nga partitura dhe i interpretojnë me mjete trupore ose instrumente Orff. Mësuesi përdor metodën dëgjon dhe përgjigjesh (*call and response)*, ku nxënësit e përsërisin ritmin. Vazhdohet më tej me një veprimtari tjetër mësimore (b) e drejtuar, *Lojë interaktive:* "Ritmi i fshehur" – një nxënës interpreton ritmin, të tjerët e identifikojnë dhe diskutojnë kohën (2/4, 3/4, 4/4). Veprimtaria e fundit (c) e drejtuar, *përdorimi i teknologjisë,* orientohen nxënësit të regjistrojnë një melodi dhe të dëgjojnë për të kontrolluar gabimet. **Hapi III. Reflektimi** Mësuesi udhëheq fazën e reflektimit dhe vetëvlerësimit të veprimtarive të zhvilluara mësimore ku nxënësit shkruajnë ose diskutojnë: "Ku gabova? Si mund ta interpretoj më saktë?"
Krijon ushtrime ritmike apo melodike në kohët 2/3/4 ritmike.	**Hapi I: Prezantimi i veprimtarisë** Veprimtaria mësimore fillon me shpjegimin e konceptit të krijimit të ritmeve dhe melodive të thjeshta, duke përdorur *pjesë të njohura muzikore* si shembuj. Mësuesi zhvillon një *Brainstorming,* ku nxënësit ndahen në grupe 3-4 vetë dhe diskutojnë idetë për ritmin ose melodinë që duan të krijojnë. Mësuesi inkurajon përdorimin e *simbolikës vizuale* ose kartonëve për të paraqitur ritmin. **Hapi II. Veprimtari mësimore e drejtuar** Zhvillohet një veprimtari mësimore (a) krijimi muzikor, ku nxënësit përdorin *instrumente Orf,* mjetet trupore me duartrokitje dhe instrumentet e perkusionit për të ndërtuar ushtrimin e tyre. Secili grup *shpjegon hapat që ndoqi për krijimin e ritmit* muzikor ose melodisë (teknika - think-aloud method). Nxënësit më pas bëjnë prezantimin ku: *Grupi luan ushtrimin për klasën.* Nxënësit e tjerë japin *komente konstruktive*, ndërsa mësuesi evidenton veçoritë shprehëse dhe ritmike.

BRAINSTORMING
ÇFARË ËSHTË RITMI?
• Ritmi është rrahja e rregullt e kohës në muzikë.
• Ai na ndihmon të këndojmë, luajmë dhe kërcejmë së bashku.
KUDO KA RITËM!
• Zemra jonë rreh.
• Hapat kur ecim.
• Pikat e shiut.
• Tingujt e natyrës.
SI E NDAJMË RITMIN?
• Me rrahje të barabarta.
• Me duart (duartrokitje).
• Me këmbët (trokëllim).
• Me instrumente ritmike.
NJOHURITË
RITMI
2, 3, 4
PËR ÇFARË NA DUHET RITMI?
• Na ndihmon të mbajmë kohën në muzikë.
• Na bën të luajmë dhe këndojmë njësoj.
• E bën muzikën të bukur dhe të rregullt.
ÇFARË NA MËSOJMË?
• Ritmet 2, 3, 4 na ndihmojnë të numërojmë rrahjet.
• Na mësojnë të ndjejmë dhe të krijojmë muzikë.


KLASTER (HARTA E IDEVE)
RITMI 2
(binar)
2
ta - ta
RITMI 3
(tresh)
3
ta - ta - ta
RITMI 4
(katërshe)
4
ta - ta - ta - ta
RITMI
PËRDORIMI
• Ecim
• Trokitim
PËRDORIMI
• Marsh
• Këngë mopullore
MBANI MEND!
Ritmi është zemra e muzikës!
Pa ritëm, s'ka muzikë.

	Hapi III. Reflektimi- Diagrami i Venit Mësuesi udhëheq fazën e reflektimit ku nxënësi flet mbi të veçantat dhe të përbashkëtat e ritmeve me 2,3 dhe 4 goditje. 

TEMATIKA 2: TEKNIKA DHE PROCESET MUZIKORE

Rezultat i të nxënit	*Veprimtari praktike*
Regjistron interpretimin e vet në instrument dhe këndim.	**Hapi I: Prezantimi i veprimtarisë** Veprimtaria mësimore fillon me dëgjimin e një interpretimi muzikor në instrument ose këndim, ku mësuesi shpjegon rëndësinë e regjistrimit të një melodie apo kënge. **Hapi II.** Regjistrimi individual: Secili nxënës regjistron interpretimin e vet në këndim apo duke luajtur në instrument përmes një tableti, smartphone ose magnetofoni të klasës. Nxënësit dëgjojnë regjistrimin dhe listojnë lidhur me intonacionin, ritmin, dinamikën dhe emocionin që ata dëgjojnë përmes këtij regjistrimi. Më pas ata bëjnë komente konstruktive duke iu drejtuar njëri-tjetrit me pyetje të tilla si: "Cila pjesë muzikore është interpretuar më mirë? Cili moment mund të përmirësohet?" **Hapi III. Reflektimi** Krijimi i portofolit digjital: Nxënësit ruajnë regjistrimet dhe reflektimet e tyre në një portofol digjital, duke ndjekur progresin vetjak gjatë gjithë vitit.
Këndon solo dhe në grup.	**Hapi I: Prezantimi i veprimtarisë** Veprimtaria mësimore fillon me prezantimin e këngës nga mësuesi, i cili mund edhe të dëgjohet në versionin solo dhe në kor. Mësuesi dhe nxënësit diskutojnë mbi rëndësinë e interpretimit dhe koordinimit. **Hapi II. Punë individuale dhe në grup (këndimi solo dhe në kor)** Të kënduarit solo - praktikë: Nxënësit këndojnë këngë me tematika të ndryshme solo, ndërsa mësuesi jep udhëzime për intonacionin dhe ritmin. Të kënduarit në grup/kor - praktikë: Nxënësit bashkohen në grupe dhe

	praktikojnë duke kënduar fragmente të ndryshme të këngës. Secili grup regjistron interpretimin e vet apo të shokëve për të dëgjuar gabimet dhe për të bërë përmirësimet e mundshme, duke i diskutuar ato. **Hapi III. Reflektimi** Mësuesi udhëheq fazën e reflektimit ku nxënësit diskutojnë: "Si ndikoi bashkëpunimi në interpretim? Si mund ta bëjmë më emocionues?"
Luan në instrumentin aerofon – fyell, notat muzikore dhe ritmet e mësuara	**Hapi I: Prezantimi i veprimtarisë** Veprimtaria mësimore fillon me demonstrimin e notave muzikore dhe ritmeve të thjeshta të mësuar në instrument, duke ruajtur intonacionin e saktë. **Hapi II. Punë individuale dhe në grup** Mësuesi drejton nxënësit të luajnë një pjesë të thjeshtë muzikore individualisht dhe më pas në grupe të vogla. Nxënësit lejohen të krijojnë një melodi të vogël duke përdorur notat muzikore dhe ritmet e mësuara. Ata regjistrojnë performancën dhe identifikojnë vendet ku intonacioni apo ritmi mund të ketë nevojë për ushtrim dhe përmirësim. **Hapi III. Reflektimi** Nxënësit japin sugjerime mbi lojën e njëri-tjetrit duke luajtur së bashku melodinë dhe duke u ushtruar më tej për koordinim në luajtje në grup.

TEMATIKA 3: HISTORIA, MUZIKA DHE SHOQËRIA

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike*
Demonstron kuptimin e formave 1-2-3 pjesëshe	**Hapi I. Prezantimi i situatës** Veprimtaria mësimore fillon me prezantimin që mësuesi bën të tre shembujve muzikorë që kanë forma të ndryshme (1-pjesëshe, 2-pjesëshe, 3-pjesëshe). Ai mund të përdorë si pajisje magnetofon dhe TV/video. Nxënësit diskutojnë rreth pjesëve muzikore që dëgjojnë duke identifikuar se si janë të ndërtuara. **Hapi II. Punë në grupe** Mësuesi drejton më tej analizën duke vendosur sërish pjesët muzikore për tu dëgjuar dhe nxënësit për secilin shembull ata shënojnë në fletore, duke përdorur *simbole vizuale ose ngjyra* për secilën pjesë. Gjithashtu, nxënësit ndahen në grupe dhe këndojnë këngë të ndryshme, duke shënuar formën e këngës që ata kanë kënduar (1-pjesëshe, 2-pjesëshe, 3-pjesëshe). Secili grup mund të krijojë një mini-kompozim dhe e prezanton në klasë. **Hapi III. Reflektimi** Mësuesi drejton nxënësit të diskutojnë: "Si ndryshon emocionin e dëgjuarit kur ndryshon rendi i pjesëve? Cila formë muzikore më pëlqeu dhe pse?" Foto paraqet këtë temë bazuar në Strukturën ERR dhe 3 teknika: Brainstorming- DDM – Diagrami i Venit
Demonstron kuptimin e ndërtimit të muzikës monodike dhe polifonike, duke dhënë veçoritë e secilës pjesë	**Hapi I: Prezantimi i veprimtarisë** Veprimtaria mësimore fillon me prezantimin e shembujve muzikorë – një kanon, një minuet dhe një këngë monodike. Diskutohet dallimi midis monodisë dhe polifonisë, përdorimi i harmonisë dhe teksturës muzikore. **Hapi II. Punë në grupe:** Mësuesi drejton nxënësit të dëgjojnë secilin shembull muzikor dhe plotësojnë një tabelë krahasuese, duke shënuar veçoritë e monodisë dhe polifonisë. Nxënësit bashkëpunojnë duke luajtur ose kënduar pjesë të thjeshta monodike dhe pastaj i kombinojnë me një pjesë tjetër për të krijuar efekt polifonik të thjeshtë.

	Hapi III. Reflektimi Mësuesi drejton nxënësit të diskutojnë se si ndryshimi midis monodisë dhe polifonisë ndikon në përjetimin emocional. Detyra: Nxënësit krijojnë një pjesë të vogël muzikore, duke përdorur kanonin ose dy linja melodike të polifonike dhe prezantojnë atë në klasë.

3. LËNDA: EDUKIM FIZIK

Tabela 1:Shembull veprimtarie për përmbushjen e RN në tematikën Edukim nëpërmjet aktiviteteve sportive.

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike 1 "Kombinime ritmike aerobike"*
Nxënësi kryen kombinacione lëvizore ritmike të gjimnastikës aerobike, shoqëruar me ritëm (muzikë ose numërim), duke demonstruar koordinim lëvizor.	Prezantimi i situatës. Mësuesi thotë: "Sot do të mësojmë disa lëvizje të gjimnastikës aerobike dhe do t'i bashkojmë ato në një kombinim të thjeshtë me ritëm muzikor. Si mendoni, si mund t'i koordinojmë lëvizjet e trupit me ritmin e muzikës?" Zhvillimi i aktivitetit: Mësuesi demonstron disa lëvizje bazë aerobike (hap anash, ngritje gjunjësh, kërcime të lehta, lëvizje të duarve). Nxënësit ekzekutojnë një kombinim të thjeshtë ritmik duke ndjekur ritmin sipas numërimit ose muzikës. Nxënësi duhet të ndjekin lëvizjet e mësuesit: ✓ *kombinojnë lëvizje të duarve dhe këmbëve,* ✓ *përshtatin lëvizjet me ritmin,* ✓ *ruajnë koordinimin dhe balancën*

	Zbatimi praktik: Nxënësit praktikojnë një kombinim të shkurtër (p.sh. 4–6 lëvizje) duke e përsëritur disa herë me muzikë. Aktiviteti zhvillohet me variante. ✓ *fillimisht me numërim → më pas me muzikë,* ✓ *ritëm i ngadaltë → më i shpejtë,* ✓ *punë në grupe për të krijuar një kombinim të thjeshtë.* Prezantimi: Nxënësit, individualisht ose në grupe, prezantojnë kombinimin e tyre para klasës, duke demonstruar koordinimin dhe përshtatjen me ritmin. Reflektimi: Mësuesi udhëzon nxënësit të reflektojnë me pyetje: ✓ *"Sa e lehtë ishte të ndiqnit ritmin e muzikës?"* ✓ *"Cilat lëvizje ishin më të lehta dhe cilat më të vështira?"* ✓ *"Si ju ndihmon ritmi për të koordinuar lëvizjet?"*

Tabela 2: Shembull veprimtarie për përmbushjen e RN në tematikën Edukim nëpërmjet aktiviteteve sportive.

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike 2 "Starti nisja në vrapim"*
Nxënësi demonstron saktë nisjen në vrapim nga starti i lartë dhe i ulët, duke pozicionuar drejt trupin dhe duke reaguar ndaj sinjalit.	Prezantimi i situatës. Mësuesi thotë: "Sot do të mësojmë si të nisim vrapimin si atletë, duke përdorur startin e lartë dhe startin e ulët. Si duhet ta pozicionojmë trupin që të nisim sa më shpejt?" Zhvillimi i aktivitetit: Mësuesi demonstron teknikën e startit të lartë dhe të ulët, duke shpjeguar pozicionin e trupit, këmbëve dhe duarve. Nxënësit i ndjekin dhe praktikojnë fillimisht pa vrapim, duke marrë pozicionin e duhur duke ndjekur komandat "Në vendet tuaja – Gati – Nisu!". Nxënësit: ✓ *marrin pozicionin e startit të lartë (trupi pak i përkulur përpara),* ✓ *marrin pozicionin e startit të ulët (një këmbë përpara, duart në tokë),* ✓ *ndjekin komandat "Në vendet tuaja – Gati – Nisu!",* ✓ *ruajnë balancën dhe përqendrimin.* Zbatimi praktik: Nxënësit praktikojnë nisjen nga starti i lartë dhe i ulët duke vrapuar në distanca të shkurtra, fillimisht pa sinjal dhe më pas me sinjal, duke u përqendruar te reagimi i shpejtë dhe pozicioni i saktë. Nxënësit praktikojnë nisjen nga të dyja startet duke vrapuar në distanca të shkurtra (10–20 m). Aktiviteti zhvillohet me variante: ✓ *fillimisht pa sinjal → më pas me sinjal (zë ose bilbil),* ✓ *start individual → në çifte ose grupe të vogla,* ✓ *përsëritje për përmirësimin e reagimit dhe shpejtësisë.*

	Prezantimi: Disa nxënës demonstrojnë para klasës nisjen nga të dyja startet, duke treguar pozicionin dhe reagimin e tyre. Reflektimi: Mësuesi udhëzon nxënësit të reflektojnë përmes pyetjeve: ✓ *"Cili start ishte më i lehtë për ju?"* ✓ *"Si ju ndihmoi pozicioni i trupit për t'u nisur më shpejt?"* ✓ *"Çfarë mund të përmirësoni herën tjetër?"*

Tabela 3:Shembull veprimtarie për përmbushjen e RN në tematikën Edukim nëpërmjet aktiviteteve sportive.

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike 3 "Loja lëvizore "Kap flamurin"*
Nxënësi njeh rregullat dhe elementet bazë të lojërave lëvizore, duke marrë pjesë aktive dhe duke bashkëpunuar me të tjerët gjatë lojës.	Prezantimi i situatës. Mësuesi thotë: "Sot do të luajmë lojën 'Kap flamurin'. Secili ekip duhet të bashkëpunojë për të marrë flamurin e kundërshtarit pa u kapur. Si mendoni, çfarë duhet të bëjmë që të fitojmë si ekip?" Zhvillimi i aktivitetit: Mësuesi shpjegon rregullat e lojës dhe ndan nxënësit në dy skuadra. Çdo skuadër ka një zonë të vetën dhe një "flamur" (shenjë ose objekt). Qëllimi është të merret flamuri i ekipit tjetër dhe të sillet në zonën e vet pa u kapur. Nxënësi duhet të: ✓ *respektojnë rregullat e lojës,* ✓ *lëvizin në fushë duke shmangur kundërshtarët,* ✓ *bashkëpunojnë me shokët e ekipit,* ✓ *përdorin strategji të thjeshta për të arritur qëllimin.* Zbatimi praktik: Nxënësit zhvillojnë lojën në disa herë, duke ndryshuar rolet dhe strategjitë. Loja mund të zhvillohet me variante: ✓ *ndryshim i madhësisë së fushës,* ✓ *shtim i më shumë se një "flamuri",* ✓ *zhvillim i lojës me kohë të kufizuar.* Prezantimi: Nxënësit tregojnë: ✓ *si bashkëpunuan me ekipin,* ✓ *si arritën të marrin ose të mbrojnë flamurin,*

	✓ *çfarë ishte më e lehtë ose më e vështirë gjatë lojës.* Reflektimi: Mësuesi udhëzon nxënësit të reflektojnë me pyetje: ✓ *"Pse është i rëndësishëm bashkëpunimi në këtë lojë?"* ✓ *"Si ju ndihmuan rregullat për ta zhvilluar lojën?"* ✓ *"Çfarë strategjie funksionoi më mirë për ekipin tuaj?"*

Veprimtari praktike 3
LOJA LËVIZORE “KAP FLAMURIN”

1. PREZANTIMI I SITUATËS

Mësuesi thotë:

“Sot do të luajmë lojën ‘Kap flamurin’. Secili ekip duhet të bashkëpunojë për të marrë flamurin e kundërshtarit pa u kapur. Si mendoni, çfarë duhet të bëjmë që të fitojmë si ekip?”

2. ZHVILLIMI I AKTIVITETIT

Mësuesi shpjegon rregullat e lojës dhe ndan nxënësit në dy skuadra. Çdo skuadër ka një zonë të vetën dhe një “flamur” (shenjë ose objekt). Qëllimi është të merret flamuri i ekipit tjetër dhe të sillet në zonën e vet pa u kapur.

Nxënësit duhet të:

- ✓ respektojnë rregullat e lojës,
- ✓ lëvizin në fushë duke shmangur kundërshtarët,
- ✓ bashkëpunojnë me shokët e ekipit,
- ✓ përdorin strategji të thjeshta për të arritur qëllimin.

3. ZBATIMI PRAKTIK

Nxënësit zhvillojnë lojën në disa herë, duke ndryshuar rolet dhe strategjitë.
Loja mund të zhvillohet me variante:

NDRYSHIM I MADHËSISË SË FUSHËS

SHTIM I MË SHUMË SE NJË “FLAMURI”

ZHVILLIM I LOJËS ME KOHË TË KUFIZUAR

4. PREZANTIMI

Nxënësit tregojnë:

- ✓ si bashkëpunuan me ekipin,
- ✓ si arritën të marrin ose të mbrojnë flamurin,
- ✓ çfarë ishte më e lehtë ose më e vështirë gjatë lojës.

5. REFLEKTIMI

Mësuesi udhëzon nxënësit të reflektojnë me pyetje:

- Pse është i rëndësishëm bashkëpunimi në këtë lojë?
- Si ju ndihmuan rregullat për ta zhvilluar lojën?
- Çfarë strategjie funksionoi më mirë për ekipin tuaj?

RREGULLAT E LOJËS (SHEMBULL)

- Nuk lejohet të shtyhet apo të pengohet kundërshtari.
- Nëse kapesh, ndalesh në vend (ose në zonë të caktuar).
- Flamuri merret dhe duhet të sillet në zonën e ekipit.
- Respektoni bashkëlojtarët dhe kundërshtarët.

Tabela 4: Shembuj veprimtarish për përmbushjen e RN në tematikën Aktiviteteve sportive.

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike 1 "Pasimi në basketboll (nga gjoksi dhe me përplasje)"*
Nxënësi demonstron saktë pasimin me dy duar nga gjoksi dhe pasimin me përplasje në tokë në basketboll, duke i përdorur ato në situata të thjeshta loje dhe duke bashkëpunuar me shokët.	Prezantimi i situatës. Mësuesi thotë: "Sot do të mësojmë dy mënyra të rëndësishme pasimi në basketboll: pasimin nga gjoksi dhe pasimin me përplasje në tokë. Si mendoni, kur përdoret secili pasim gjatë lojës?" Zhvillimi i aktivitetit: Mësuesi demonstron të dy teknikat e pasimit, duke shpjeguar pozicionin e duarve dhe drejtimin e topit. Nxënësit punojnë në çifte dhe praktikojnë pasimet duke ndjekur udhëzimet dhe duhet të. ✓ *realizojnë pasimin nga gjoksi drejt shokut,* ✓ *realizojnë pasimin me përplasje në tokë,* ✓ *mbajnë qëndrim të saktë të trupit,* ✓ *bashkëpunojnë dhe respektojnë rregullat.* Zbatimi praktik: Nxënësi duhet të praktikojnë pasimet në distanca të ndryshme dhe me ritme të ndryshme. Aktiviteti zhvillohet me variante: ✓ *pasime në vend → pasime në lëvizje,* ✓ *distancë e shkurtër → më e gjatë,* ✓ *shtim i një kundërshtari pasiv për vështirësi më të madhe.* Prezantimi: Disa nxënës demonstrojnë para klasës të dy llojet e pasimeve, duke treguar teknikën dhe saktësinë e tyre. Reflektimi: Mësuesi udhëzon nxënësit të reflektojnë me pyetje: ✓ *"Cili pasim ishte më i lehtë për ju?"*

	✓ *"Kur është më i përshtatshëm pasimi me përplasje në tokë?"* ✓ *"Si ju ndihmon pasimi i saktë në lojën në ekip?"*

VEPRIMTARIVE PRAKTIKE 1
PASIMI NË BASKETBOLL (NGA GJOKSI DHE ME PËRPLASJE)

1. ZHVILLIMI I AKTIVITETIT

Mësuesi demonstron të dy teknikat e pasimit, duke shpjeguar pozicionin e duarve dhe drejtimin e topit. Nxënësit punojnë në çifte dhe praktikojnë pasimet duke ndjekur udhëzimet.

PASIM NGA GJOKSI

PASIM ME PËRPLASJE (NË TOKË)

NXËNËSIT DUHET TË:

- realizojnë pasimin nga gjoksi drejt shokut,
- realizojnë pasimin me përplasje në tokë,
- mbajnë qëndrim të saktë të trupit,
- bashkëpunojnë dhe respektojnë rregullat.

2. ZBATIMI PRAKTIK

Nxënësit praktikojnë pasimet në distanca të ndryshme dhe me ritme të ndryshme. Aktiviteti zhvillohet me variante:

PASIME NË VEND → PASIME NË LËVIZJE

DISTANCAT E SHKURTËR → MË E GJATË

SHTIM I NJË KUNDËRSHTARI PASIV

3. PREZANTIMI

Disa nxënës demonstrojnë para klasës të dy llojet e pasimeve, duke treguar teknikën dhe saktësinë e tyre.

ELEMENTET TEKNIKE KRYESORE

PASIM NGA GJOKSI

- Duart në nivel të gjoksit
- Elboët hapur
- Shtyje e topit përpara
- Topi shkon drejt gjoksit të shokut

PASIM ME PËRPLASJE

- Shtyje e topit drejt tokës
- Topi përplaset rreth 2/3 e distancës
- Shoku e pret me duar poshtë

Tabela 5: Shembuj veprimtarish për përmbushjen e RN në tematikën Aktiviteteve sportive.

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike 2 "Shërbimi nga poshtë në volejboll"*
Nxënësi demonstron shërbimin me një dorë nga poshtë në volejboll, duke e realizuar saktë teknikën dhe duke e dërguar topin në drejtim të fushës kundërshtare.	Prezantimi i situatës. Mësuesi thotë: "Sot do të mësojmë një teknikë të rëndësishme në volejboll: shërbimin me një dorë nga poshtë. Si mund ta godasim topin që të kalojë mbi rrjetë dhe të shkojë drejt fushës kundërshtare?" Zhvillimi i aktivitetit: Mësuesi demonstron teknikën e shërbimit nga poshtë, duke shpjeguar pozicionin e trupit, këmbëve dhe dorës që godet topin. Nxënësit praktikojnë fillimisht lëvizjen pa top, pastaj me top. Nxënësit: ✓ *qëndrojnë me njërën këmbë përpara,* ✓ *mbajnë topin në njërën dorë,* ✓ *godasin topin me dorën tjetër nga poshtë,* ✓ *përpiqen ta dërgojnë topin mbi rrjetë,* ✓ *respektojnë radhën dhe hapësirën e shokëve.* Zbatimi praktik: Nxënësit praktikojnë shërbimin duke qëlluar në fushë të shënuar ose mbi rrjetë. Aktiviteti zhvillohet me variante: ✓ *shërbim në distancë të shkurtër → më të gjatë,* ✓ *shërbim drejt objektivave të caktuara,* ✓ *përsëritje për përmirësim të saktësisë dhe fuqisë.* Prezantimi: Disa nxënës demonstrojnë para klasës shërbimin nga poshtë, duke treguar teknikën dhe drejtimin e topit. Reflektimi: Mësuesi udhëzon nxënësit të reflektojnë me pyetje:

	✓ *"Si e realizuat goditjen e topit?"* ✓ *"Çfarë duhet të bëjmë që topi të kalojë mbi rrjetë?"* ✓ *"Si mund të përmirësojmë saktësinë e shërbimit?"*

Tabela 6 : Shembuj veprimtarish për përmbushjen e RN në tematikën Aktiviteteve sportive.

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike 3 "Udhëheqja e topit në futboll"*
Nxënësi demonstron udhëheqjen e topit në futboll duke kontrolluar topin me këmbë gjatë lëvizjes dhe duke bashkëpunuar në situata të thjeshta loje.	Prezantimi i situatës. Mësuesi thotë: "Sot do të mësojmë si të udhëheqim topin në futboll, duke e kontrolluar atë me këmbë gjatë lëvizjes. Si mund ta mbajmë topin pranë vetes pa e humbur?" Zhvillimi i aktivitetit: Mësuesi demonstron teknikën e udhëheqjes së topit me këmbë, duke shpjeguar kontaktin e lehtë me topin dhe kontrollin gjatë lëvizjes. Nxënësit praktikojnë fillimisht në vend dhe më pas në lëvizje të ngadaltë. Nxënësit: ✓ *udhëheqin topin me pjesë të ndryshme të këmbës (shputa, pjesa e brendshme),* ✓ *mbajnë topin afër trupit gjatë lëvizjes,* ✓ *kontrollojnë shpejtësinë e topit,* ✓ *respektojnë hapësirën dhe shokët.* Zbatimi praktik: Nxënësit praktikojnë udhëheqjen e topit në një drejtim të shënuar ose me pengesa të lehta. Aktiviteti zhvillohet me variante: ✓ *udhëheqje e ngadaltë → më e shpejtë,* ✓ *ndryshim drejtimi gjatë lëvizjes,* ✓ *kalim përmes pengesave të thjeshta.* Prezantimi: Nxënësit demonstrojnë udhëheqjen e topit, duke treguar kontrollin dhe lëvizjen e tyre në fushë. Reflektimi: Mësuesi udhëzon nxënësit të reflektojnë me pyetje: ✓ *"Si e mbajtët topin nën kontroll gjatë lëvizjes?"*

	✓ *"Cila pjesë e këmbës ju ndihmoi më shumë?"* ✓ *"Çfarë duhet të përmirësoni për të udhëhequr më mirë topin?"*

Tabela 7. Shembuj veprimtarish për përmbushjen e RN në tematikën Edukim për shëndetin

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike 1 "Zgjedhjet e ushqimit të shëndetshëm"*
Nxënësi shpjegon rëndësinë e të ushqyerit të shëndetshëm dhe identifikon ushqimet e shëndetshme, duke bërë zgjedhje të sakta për një dietë të balancuar.	Prezantimi i situatës. Mësuesi thotë: "Sot do të flasim për ushqimin e shëndetshëm. Si mendoni, cilat ushqime janë të mira për trupin tonë dhe cilat duhet t'i konsumojmë më rrallë?" Zhvillimi i aktivitetit: Mësuesi paraqet një tabelë ose figura me ushqime të ndryshme. Nxënësit i klasifikojnë ato në grupe (të shëndetshme dhe më pak të shëndetshme) dhe diskutojnë rëndësinë e secilit grup ushqimor. Nxënësit: ✓ *dallojnë ushqimet e shëndetshme dhe jo të shëndetshme,* ✓ *shpjegojnë pse disa ushqime janë të rëndësishme për trupin,* ✓ *marrin pjesë në diskutim në grup,* ✓ *japin shembuj nga ushqimi i përditshëm.* Zbatimi praktik: Nxënësit analizojnë në grupe disa shembuj ushqimesh dhe diskutojnë cilat janë të shëndetshme dhe cilat jo. Ata japin arsye për zgjedhjet e tyre dhe propozojnë një mënyrë të ushqyerit të shëndetshëm për një ditë, duke bashkëpunuar dhe duke shkëmbyer mendime. Nxënësit punojnë në grupe dhe krijojnë një "menu të shëndetshme" për një ditë (mëngjes, drekë, darkë), duke zgjedhur ushqime të balancuara dhe të përshtatshme. Prezantimi: Disa grupe prezantojnë menunë e tyre dhe shpjegojnë zgjedhjet që kanë bërë, duke treguar pse janë të shëndetshme. Disa nxënës të tjerë paraqesin idetë e tyre duke argumentuar pse ushqimet e përzgjedhura janë të shëndetshme.

Reflektimi: Mësuesi udhëheq një diskutim në klasë, ku nxënësit shprehin mendimet e tyre për rëndësinë e ushqyerjes së shëndetshme dhe ndikimin e saj në trup dhe energji, si dhe japin ide se si mund të përmirësojnë zakonet e tyre ushqimore. Mësuesi udhëzon nxënësit të reflektojnë përmes diskutimit:

- ✓ *"Pse është e rëndësishme të ushqehemi shëndetshëm?"*
- ✓ *"Si ndikon ushqimi në trupin dhe energjinë tonë?"*
- ✓ *"Çfarë mund të përmirësojmë në ushqyerjen tonë të përditshme?"*

Tabela 8. Shembuj veprimtarish për përmbushjen e RN në tematikën Edukim për shëndetin

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike 2 "Aktiviteti fizik dhe shëndeti im"*
Nxënësi identifikon përfitimet që sjell aktiviteti fizik në jetën e përditshme dhe ndikimet që ka veprimtaria fizike te shëndeti.	Prezantimi i situatës. Mësuesi thotë: "Sot do të flasim e të diskutojmë për rëndësinë e aktivitetit fizik. Si ndihmon aktiviteti fizik trupin dhe mendjen tonë? Çfarë ndodh kur lëvizim dhe kur qëndrojmë pa lëvizur për një kohë të gjatë?"

Zhvillimi i aktivitetit: Mësuesi prezanton shembuj të ndryshëm të aktivitetit fizik (ecje, vrapim, lojëra sportive). Nxënësit diskutojnë në grupe dhe japin shembuj nga përditshmëria e tyre.

Nxënësit:

- ✓ *identifikojnë përfitime të aktivitetit fizik (rritje e energjisë, shëndet më i mirë, humor më i mirë),*
- ✓ *dallojnë ndikimet pozitive në trup (zemra, muskujt, qëndrueshmëria),*
- ✓ *japin shembuj të aktivitetit fizik që bëjnë gjatë ditës,*
- ✓ *bashkëpunojnë në diskutim në grup.*

Zbatimi praktik (mësim teorik): Nxënësit analizojnë situata të ndryshme të përditshme dhe diskutojnë për ndikimin e aktivitetit fizik në trup dhe shëndet. Ata punojnë në grupe dhe përshkruajnë përfitimet e aktivitetit fizik, duke krahasuar një ditë aktive me një ditë pasive (pa lëvizje), si dhe japin shembuj konkretë nga përvoja e tyre.

	Prezantimi: Disa nxënës paraqesin përfundimet e tyre, duke treguar: ✓ *cilat janë përfitimet e aktivitetit fizik,* ✓ *si ndikon ai në shëndet dhe në ndjesinë e përgjithshme,* ✓ *shembuj të aktivitetit fizik që mund të bëjnë gjatë ditës.* Reflektimi: Mësuesi udhëheq një diskutim të shkurtër në klasë, ku nxënësit shprehin mendimet e tyre për rëndësinë e aktivitetit fizik. Ata analizojnë përfitimet e tij për shëndetin dhe japin ide se si mund të jenë më aktivë në jetën e përditshme, duke lidhur njohuritë me përvojat e tyre. Disa nxënës paraqesin përfundimet e tyre, duke treguar: ✓ *cilat janë përfitimet e aktivitetit fizik,* ✓ *si ndikon ai në shëndet dhe në ndjesinë e përgjithshme,* ✓ *shembuj të aktivitetit fizik që mund të bëjnë gjatë ditës.*